

URDHËR
Nr. 373/5, datë 23.12.2021

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021,
“PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, germa “d”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5180, datë 23.12.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, të ndryshuar, bëhet shitesa si vijon:

1. Pas pikës 1 të urdhrit, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Përjashtim, nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të urdhrit, bëhet vetëm për natën e ndërrimit të viteve, datë 31.12.2021–1.1.2022.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu